



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë Ligji Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010) të nenit 4 paragrafi 1.27, nenit 3 paragrafi 6 të Ligji Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për këshillin prokurorial të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17 publikuar me 30 qershor 2015, Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 05 nëntor 2015 miraton:

R R E G U L L O R E NR. 04 / 2015

PËR SKEMËN E KOMPENZIMIT TË ANËTARËVE DHE KOMISIONEVE TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe shumës së kompensimit të anëtarëve të KPK-së.

Neni 2
Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj Rregulloreje kufizohet vetëm në rregullimin e skemës së kompensimit për punën e anëtarëve, komisioneve dhe trupave të tjerë të KPK-së, në përputhje me ligjet në fuqi.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

“KPK” Këshillin Prokurorial të Kosovës.

“Kompensim” kompensimin në të holla.

Neni 4

Parimet e përgjithshme

Secili anëtar i KPK-së ka të drejtë në kompensim. Kompensimi i anëtarëve të KPK bazohet në parimin e ligjshmërisë, barazisë dhe objektivitetit.

Neni 5

Kompensimi i anëtarëve të KPK-së

5.1 Anëtarët e KPK-së kompenzohen në shumën deri në 25% të pagës bazë mujore, përjashtuar kryesuesin dhe zëvendës-kryesuesin e KPK-së.

5.2 Kompensimi nga pika 1 përshin kompensimin e anëtarëve të KPK-së për punën e tyre në KPK duke përfshirë edhe punën në komisionet e përhershme dhe trupat e tjerë ndihmës të KPK-së.

5.3 Të gjithë anëtarët e KPK-së, me përjashtim të kryesuesit, zëvendës kryesuesit dhe përfaqësuesit të Odës së Avokatëve të Kosovës do të kompenzohen bazuar në pagën bazë të prokurorit të Prokurorisë Themelore.

5.4 Paga bazë për anëtarët nga pika 3 e këtij neni merret paga bazë bruto e Prokurorit të Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore, në kuadër të organizatës buxhetore "Prokurori i Shtetit".

5.5 Paga e anëtarit të KPK nga Oda e Avokatëve rregullohet në pajtim me nenin 3.6 të Ligjit Nr. 05/L-035 për ndryshimin e ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Neni 6

Kompensimi i kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të KPK

Kompensimi i Kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të KPK-së bëhet në përputhje me nenet 4 dhe 5/A, paragrafi 5, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-035 për ndryshimin e ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Neni 7

Kompensimi i anëtarëve të këshillit dhe trupave ndihmëse të KPK-së

KPK me vendim do të caktoj mënyrën dhe shumën e kompensimit të kryesuesve, anëtarëve të komisioneve dhe trupave të themeluar nga ana e tij.

Neni 8
Rimbursimi i anëtarëve të KPK-së

8.1 Anëtarët e KPK-së kanë të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve të kryera për punën e tyre në KPK, komisionet e përhershme dhe trupat ndihmës të KPK-së.

8.2 Kategoritë dhe shuma e rimbursimit rregullohen me vendim të veçantë nga KPK.

Neni 9
Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.01.2016.

Prishtinë, më 05 nëntor 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kryesues Aleksandër Lumezi

